



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

1

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

ANALIZA VJETORE 2023

Nr. _____ Prot.

Durrës, më 24.01.2024

PËRMBAJTJA

- ❑ MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE
- ❑ MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR DHE BASHKITË
- ❑ DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA
- ❑ MBROJTJA CIVILE
- ❑ FUNKSIONET E DELEGUARA
- ❑ VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE
- ❑ SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE
- ❑ DETYRAT DHE PRIORITETET PËR VITIN 2024

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Veprimtaria një vjeçare dhe e përditshme e Institucionit të Prefektit ka konsistuar në realizimin e objektivave, implementimin dhe zbatimin e prioriteteve dhe politikave të Qeverisë. Ka konsistuar në ndërtimin e një marrëdhënie të bashkëpunimit reciprok si në marrëdhëniet qendrore në nivel vendor, ashtu dhe me organet e vetqeverisjes vendore, duke bashkërenduar gjithashtu veprimtaritë e tyre, me qëllim-realizimin e objektivave të qeverisë në ruajtjen e rendit dhe sigurinë, ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetsore cilësore si dhe monitorimin e çdo lloj veprimtarie ligjore të institucioneve në qark.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës ka:

- Zbatuar Urdhërat dhe Udhëzimet e ardhura nga autoritetet qendrore.
- Koordinuar punët dhe bashkërenduar veprimtarinë me Degët Territoriale që veprojnë në Qark.
- Koordinuar veprimtarinë ndërmjet vetë Degëve Territoriale, si dhe të këtyre me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.
- Dërguar informacione, raporte periodike në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e Degëve Territoriale, sipas Urdhërit të Kryeministrit, dhe për probleme të veçanta, sipas Urdhërit të Ministrit.
- Dërguar informacione, raporte mujore në Ministrinë e Brendshme sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm dhe për probleme të veçanta.
- Parandalimi dhe menaxhimi i emergjencave civile, lufta kundër kanabisit etj.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

INFRASTRUKTURA

Gjatë vitit 2023 i është kushtuar rëndësi të veçantë **infrastrukturës rrugore në nivel qarku**, kryesisht në sigurinë e rrugëve nacionale dhe atyre vendore. Gjatë 2023 **janë zhvilluar 2 takime të rëndësishme me aktorët përgjegjës. Prefekti i Qarkut** ka monitoruar punën e strukturave përgjegjëse, ku si arritje për vitin 2023 përmendim:

- Ka një performancë të mirë të punës të kompanive të kontraktuara nga ARRSH në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të tyre për rrugët në qarkun Durrës.
- Ka një vëmendje të shtuar nga NJVV-re në planifikimin dhe alokimin e fondeve në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, në shërbime e mirëmbajtje. Investimet kanë qenë kryesisht në shtrim rrugësh me asfalt, ndriçimi i tyre me LED etj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Problematikat kryesore të infrastrukturës rrugore të evidentuara gjatë vitit 2023 nga Institucioni i Prefektit janë:

- Nevojitet një vëmendje e shtuar në mirëmbajtjen e rrugëve **në kohë** dhe **cilësi** nga strukturat përgjegjëse të bashkive edhe nga firmat kontraktore për rrugët nën administrimin e ARRSH
- **Nevoja për sinjalistikë vertikale dhe horizontale**, në disa rrugë të bashkive kryesisht në zonat periferike të tyre.
- Duhet një **menaxhim më i mirë i trafikut në segmente të caktuara rrugore**, apo në hyrje daljet e qyteteve gjatë periudhave të pikut të qarkullimit të mjeteve.
- Lind **nevoja e përdorimit të rrugëve alternative dytësore**, për të lehtësuar trafikun e rënduar në periudha të caktuara kryesisht gjatë periudhave të pikut të qarkullimit të mjeteve. Kështu mund të përmendim; Rrugën dytësore Golem-Plepa me kalim nga ana e Shkëmbit të Kavajës, Gjiri i Lalëzit-Maminas me kalim nga Sukthi, Currila-Durrës me kalim nga kodra e qytetit etj. Një element i rëndësishëm duhet të jetë edhe ndërgjegjësimi (orientimi) dhe informimi i qytetarëve për përdorimin e këtyre rrugëve alternative me qëllim lehtësimin e trafikut në ditë apo periudha piku.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

- **Nevoja për planifikim edhe më të madh fondesh në buxhetet e bashkive për investim në rrugët rurale.** (Edhe pse për vitin 2024 ka planifikim për investime në rrugë nga bashkitë, gjykojmë se duhet akoma më shumë).
- **Nevoja për një qëndër monitorimi me sistem kamerash sidomos në pjesët e qytetit ku trafiku është më i rënduar.**
- **Mospërfundimi ende i procesit të kalimit të rrugëve nga ARRSH te Bashkia Shijak, kjo në zbatim të VKM-së Nr.600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve".** (De fakto është kaluar me VKM, nuk është bërë ende procedura shkresore për marrjen në dorëzim të rrugëve Shijak - Maminas (5 km) dhe Shijak - (K/Komunë) Gjepalaj (6.3km) nga Bashkia Shijak.
- **Parkimet e makinave të nxjerra në shitje anës rrugëve për një kohë të gjatë apo abuzimet në parkingjet publike pa pagesë.** Për këtë Institucioni i Prefektit ka zhvilluar takime, për ndërhyrjen e strukturave përgjegjëse në zgjidhjen sa më të shpejtë të tyre, gjë e cila ka dhënë rezultatet e saj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

- Është e domosdoshme që në qytetin e Durrësit të fillojë të **aplikohet sistemi i parkingjeve me pagesë në rrugët kryesore të qytetit dhe të aplikohet sistemi i parkimit rezidencial.**
- Policia Bashkiake duhet të disponojë karrotrec për largimin e mjeteve të parkuara gabim, si dhe një **vend të autorizuar për vendosjen e tyre.**
- Nevoja e **një studimi konkret të rrugëve të bashkisë Durrës për organizimin e lëvizshmërisë së mjeteve në rrugët brenda qytetit me një sens,** në mënyrë që të disiplinohet dhe lehtësohet trafiku i mjeteve. Kjo gjë është implementuar në disa rrugë të qytetit dhe ka rezultuar efikase, duhet të shtrihet edhe më gjerë në të gjithë qytetin.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Objektivat për vitin 2024 në drejtim të infrastrukturës rrugore

1. Ndjekja e problematikave dhe organizimi i takimeve për marrjen e masave nga strukturat përgjegjëse për infrastrukturën rrugore, për një siguri maksimale të rrugëve në qark.
2. Marrja e masave për rritjen e performancës së strukturave përgjegjëse në drejtim të pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
3. Angazhimi i Institucionit të Prefektit në nxitjen e realizimit të një studimi dhe projekti teknik të përgjithshëm dhe të detajuar për qarkullimin e mjeteve në akset rrugore të qytetit të Durrësit, kjo në funksion të përmirësimit të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve.
 - Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere, por edhe ndëshkuese nga strukturat përgjegjëse në raport me qytetarët dhe mjetet qarkulluese në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor.
1. Angazhimi në përfundimin ligjor të procesit të kalimit të rrugëve nga ARRSH te Bashkia Shijak dhe anasjelltas, si dhe vëmëndja që duhet të tregojë kjo bashki në mirëmbajtjen e tyre.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

OSHEE - ENERGJIA ELEKTRIKE

Si një nga produktet dhe shërbimet më të rëndësishme jo vetëm për individët, por edhe në zhvillimin ekonomik të vendit, **menaxhimi dhe ofrimi i shërbimit të enegjisë elektrike** nga OSHEE, ka qënë prioritet i vëmëndjes së Prefektit të Qarkut. Kjo gjë është bërë duke ndjekur dhe monitoruar punën e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE-së) dega Durrës, si dhe implementimin e politikave të ndërmarra nga qeveria shqiptare për menaxhimin sa më efektiv të saj.

► Për këtë gjatë vitit 2023 janë zhvilluar takime me drejtues të OSHEE-së dega Durrës për t'u njohur me situatën dhe menaxhimin e këtij sektori në qarkun tonë. **Janë marrë informacione në mënyrë periodike** mbi situatën e furnizimit, difektet dhe remontet e kryera nga strukturat e OSHEE-së.

► Është ndjekur dhe monitoruar situata e furnizimit me energji elektrike për një **menaxhim sa më të mirë të sezonit turistik veror 2023** në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, i cili **ka rezultuar pa problematika thelbësore**. Nga OSHEE si përgjatë sezonit turistik por edhe periudhës vjeshtë-dimër apo fundvitit janë hartuar planet e masave për mbarëvajtjen e furnizimit me energji elektrike, si dhe janë vënë në gatishmëri grupet e punës për zgjidhjen e difekteve në një kohë mjaft të shpejtë.

► Investimet e kryera nga Bashkia Durrës për **zëvëndësimin e ndriçimit të vjetër me atë të teknologjisë LED** kanë ndikuar jo vetëm në rritjen e cilësisë dhe standartit të elementeve të rrugëve të qytetit, por dhe në drejtim të uljes së konsumit të energjisë elektrike.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

MJEDISI

Mjedisi ka qenë prioritet i punës tonë përgjatë vitit 2023, kjo jo vetëm në ndjekjen, monitorimin e situatës në qarkun tonë, por edhe në koordinimin dhe bashkërendimin e punës për çdo problematikë të dalë në këtë drejtim.

Gjatë 2023 Prefekti i Qarkut ka zhvilluar **2 takime** me strukturat përgjegjëse dhe të angazhuara në aksionet e pastrimit, ku ndër çështjet më të rëndësishme të trajtuara kanë qenë:

- ✓ **Planet e veprimit dhe informacionet** që do të përcilleshin nga strukturat përgjegjëse.
- ✓ **Menaxhimi i mbetjeve në të tre bashkitë** (fondet e planifikuara për këtë qëllim bazuar mbi koston e menaxhimit të mbetjeve në buxhetet e tyre).



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

✓ **Ztbaimi i Udhëzimit Nr. 1, datë 24.03.2022 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit**, "Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa makina", **i cili përcakton si ditë pa makina të dielën e parë të çdo muaji**, nga Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë. Kjo nismë synon ndërgjegjësimin e qytetarëve për një mjedis më të pastër nga CO2, si dhe promovimin e përdorimit të mjeteve alternative të transportit.

✓ **Rivitalizim (mbjellja e pemëve)** në territorin e bashkive respektive.

✓ **Angazhimi i shkollave në aksione pastrimi** në bashkëpunim edhe me OJF të ndryshme.

✓ Angazhimi i strukturave në **ndërgjegjësimin e komunitetit dhe nxënësve** në fushata ndërgjegjësimi për të eliminuar qeset plastike, etj.

Në kuadër të menaxhimit të **Planit Kombëtar të Pastrimit**, Prefekti i Qarkut ka monitoruar përgjatë gjithë vitit punën për pastrimin e territorit, pastrimin e vijës bregdetare dhe zonave turistike etj. Si rezultat paraqesim këto të dhëna:



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Tabela e aksioneve të pastrimit të kryer në qarkun Durrës për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe 2023

QARKU	NUMRI I FORCAVE TË ANGAZHUARA	NR. MJETEVE TË PËRDORURA	NR. I HOTSPOTEVE TË PASTRUARA	SASIA E MBETJEVE TË PASTRUARA (ton)
viti 2022	3904	24	272	12417.8
viti 2023	3958	24	246	1388.05

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Shënim:

Siç shikohet edhe nga grafikët sasia e mbetjeve të pastruara për vitin 2023 është gati 10-herë më pak krahasuar me vitin 2022, kjo për faktin se:

1. Plani Kombëtar i Pastrimit ka filluar që në Nëntor të 2021, vit në të cilin kanë qenë fillimet e këtyre aksioneve dhe për pasojë hotspotet e evidentuara kanë pasur më shumë mbetje të akumuluar ndër vite.
2. Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në sasinë e ulët të mbetjeve është edhe **ndërgjegjësimi i qytetarëve apo edhe i bizneseve** (*ndëshkimi i disa prej tyre*) për mos hedhjen e mbetjeve përsëri në këto hotpote të pastruara më parë.
3. Ka zona të caktuara ku hidhen mbetje në mënyrë të paligjshme apo edhe zona të cilat edhe pse pastrohen në mënyrë të vazhdueshme përsëri ato mbeten pika mjaft të nxehta grumbulli mbetjesh. Të tilla janë brigjet e lumenjve ku hidhen mbetje nga persona apo subjekte të paidentifikuar apo edhe grykëderdhja e lumit Ishëm, e cila mbetet një pikë mjaft problematike grumbullimi mbetjesh. Për këtë gjë lind nevoja e një bashkëpunimi dhe koordinimi pune në bazë më të gjerë se njësisia e vetqeverisjes vendore (bashkëpunim ndër rajonal, por edhe ndërhyrje nga qeveria shqiptare).

Theksojmë se shifrat e paraqitura më sipër janë tonazhi i mbetjeve të grumbulluara nga aksionet e pastrimit të zhvilluara nga njësitë e vetqeverisjes vendore apo organizata të ndryshme që veprojnë në qark, në ndihmë të pastrimit të territorit dhe mbajtjes pastër të mjedisit, pra jo sasia totale të pastruara nga puna e përditshme e ndërmarrjeve të pastrimit të Bashkive apo subjekteve të kontraktuara për pastrimin e qytetit.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Ndalimi i përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme

- ▶ Institucioni i Prefektit ka qenë i angazhuar në këtë proces në mënyrë të veçantë në ndalimin e prodhimit, hedhjes në treg apo përdorimit të qeseve plastike jo konform kriterëve ligjore. Për këtë gjatë 2023 janë zhvilluar **2 takime** të rëndësishme me strukturat përgjegjëse pjesë të Task-Forcës së ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.190 dt.15.11.2022.
- Nga Prefekti është kërkuar zbatimi i të gjitha detyrimeve ligjore nga strukturat përgjegjëse (Ligjit nr. 28/2022 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga VKM Nr. 367, datë 30.5.2022 për këtë qëllim.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Përgjatë 2023 konstatojmë se:

- Në këtë proces **ka një rezultat pozitiv** në reduktimin e përdorimit të qeseve plastike një-përdorimshe sipas kriterëve ligjore.
- Gjithnjë e më tepër nga subjektet e shërbimeve apo edhe qytetarët po **përdoren qeset sipas kriterëve ligjore**, çantat e bezeve apo kartoni në mënyrë të veçantë në supermarkete dhe dyqanet kryesore.
- **Problematicë mbetet ende tregu ushqimor dhe industrial si dhe dyqanet e lagjeve në zonat periferike** të qytetit në të cilat ende në disa raste përdoren qeset jashtë kriterëve ligjore.
- Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, kësaj të fundit i është shtuar **kompetenca e verifikimit të respektimit të normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje të qeseve plastike**, gjë që ka obliguar këtë strukturë të ushtroj kontrole të vazhdueshme në këto tregje.

Prioritet për 2024:

- Vëmëndje e shtuar e Prefektit të Qarkut do të jenë edhe kontrollet që do të ushtrohen nga ana Agjensia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në subjektet e prodhimit të qeseve plastike gjatë periudhave të ndryshme me qëllim kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore për prodhimin e tyre.
- Kjo çështje do të jetë prioritet i punës sonë dhe strukturave përgjegjëse edhe përgjatë vitit 2024 në evidentimin e rasteve dhe ndërhyrjen e tyre për marrjen e masave në këtë drejtim.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

► **Problematikat kryesore në mbrojtjen e Mjedisit të evidentuara gjatë vitit 2023 në drejtim të mbetjeve janë:**

1. Mungesa e një venddepozitimi për leshterikun (Bashkia Durrës) dhe mbetjet inerte (Bashkia Durrës, Shijak, Krujë). Nga të tre bashkitë nuk ka ende të miratuar një venddepozitim për inerte.
 2. Hedhje të inerteve nga individë apo subjektet private në vende të paligjshme (raste sporadike)
 3. Moszbatimi nga një pjesë e bizneseve të orarit të hedhjes së mbetjeve në koshat përkatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00 të mëngjesit, sidomos gjatë periudhës së sezonit turistik veror (Bashkia Durrës), orar ky i shtrirë tashmë gjatë gjithë vitit.
 4. Ndotja e vazhdueshme e disa zonave të cilat pasi pastrohen, për një kohë shumë të shkurtër rimbushen me mbetje nga vetë qytetarët. Veçanërisht ngelen problematike zonat periferike të Bashkive Durrës, Krujë dhe Shijak ku largësia dhe terreni i vështirë në zonat rurale e bën të vështirë kontrollin dhe ndërhyrjen nga ana e shërbimeve të pastrimit.
- Në disa fshatra vazhdojnë të hidhen mbetje urbane në rrjedha uji, përrenj dhe lumenj. Kjo është një problematikë e dukshme për zonat turistike kodrinore siç janë Ishmi, Qafshatama, zona e mbrojtur, fshatrat e Shijakut në brigjet e lumit Erzen etj.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

► RIVITALIZIMI

Vëmendje i është kushtuar shtimit të hapësirave të gjelbëra në të gjithë qarkun. Gjatë vitit 2023 kemi ndjekur dhe monitoruar disa ndërhyrje në drejtim të rivitalizimit ku ndër më kryesorët përmendim:

Në bashkinë Durrës janë mbjellur:

Pemë: 230 copë

- Blin-50 cope(lulishtja tek hyrja e Durrësit)
- Pisha-100 cope(77 shetitorja e plazhit dhe 23 shetitorja Taulantia)
- Palme ëashingtonia-20 cope(shetitorja Taulantia)
- Panjë-50 cope(Hyrja e Durrësit)
- Oleander-30 cope(Shetitorja Taulantia).

Shkurre dekorative: 9250 copë (të mbjella në rotondat e qytetit)

Lule sezonale: 9300 copë (të mbjella në rotondat e qytetit)

- **Në bashkinë Krujë** është ndjekur dhe monitoruar mbjellja e pemëve në zonën e Fushë-Krujës dhe fshatin Dukagjin i Ri në zonën e Thumanës.
- **Në bashkinë Shijak** është ndjekur mbjellja e pemëve në Nj. Ad. Xhafzotaj. Janë mbjellur 44 pemë Bli dhe 19 pemë Ullinj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

Objektivat për vitin 2024 në mbrojtjen e mjedisit:

Prefekti i Qarkut do të organizojë dhe do të koordinojë strukturat përgjegjëse për mbrojtjen mjedisore në këto drejtime:

- Vazhdimi i Planit Kombëtar të Pastrimit “Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore”, organizimi i aksioneve të ndryshme pastrimi në bashkëpunim me strukturat dhe institucionet vendore në qark.
- Realizimi i fushatave sensibilizuese për angazhimin dhe edukimin e brezit të ri, ndërgjegjësimin e njerëzve për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.
- Vëmendje të theksuar do të ketë zbatimit i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve brenda territorit të qarkut dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të pushtetit vendor, qendror dhe sektorit privat.
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e parqeve, lulishteve, hapsirave të gjelbërta dhe pasurive natyrore.
- Rritjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit për evindentimin e shkeljeve që bëhen në rastet e ndotjes mjedisore, hedhjeve të mbetjeve në vende jo të autorizuar, ndotjet të ndryshme në nivel qarku.
- Do t’i kushtohet një vëmendje maksimale pastrimit të rrugëve që të çojnë në zonën bregdetare apo në zonat turistike.
- Puna jonë do të orientohet dhe në drejtim të rivitalizimit (mbjelljes së pemëve). Duhet të jetë në vëmendje të njërive të vetqeverisjes vendore apo strukturave përgjegjëse shtimi i hapësirave të gjelbërta.

INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRËS

INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRES

► Gjatë këtij viti kemi ndjekur mbarëvajtjen e investimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomiko-social dhe urban. Në qarkun tonë po bëhen investime strategjike shumë të rëndësishme jo vetëm për qytetin e Durrësit por për të gjithë Shqipërinë dhe rajonin.

► Ndër investimet më të rëndësishme që janë ndjekur përgjatë 2023 dhe që do jenë në vëmendjen tonë edhe për vitin 2024 mund të përmendim;

- **Porti i Ri Tregtar në Porto Romano,**
- **Porti Turistik i Durrësit,**
- **Hekurudha Tiranë-Durrës,**
- **Aksi i ri rrugor Thumanë – Kashar**
- **Parku i madh shumëfunksional "Vala" në lagjen 18,**
- **Parkimi Publik pranë Stacionit të Trenit,**
- **Lungomare e Re e Plazhit të Durrësit,**
- **Projekti Eco Park**
- **Aksi i ri rrugor Thumanë – Kashar**

► Këto investime do të kenë impakt pozitiv në zhvillim ekonomik të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, në zhvillimin afatgjatë me rëndësi kombëtare e rajonale, do të ketë përmirësim të imazhit të vendit, si mikpritës i investitorëve të huaj dhe si garantues i tyre.



INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRËS

Projekti	Porti i Ri Tregtar në Porto Romano
Investimi	427 milionë euro
Specifikimet Teknike	– sipërfaqe prej 400 hektarë. – kapc. prej 2 milionë kontenierë deri në 50 milionë tonelata. – deri në 1 milion pasagjerë.
Fillimi i Punimeve	2024
Mbarimi i Punimeve	2026
Projekti	Projekti i Marinës Turistike të Durrësit
Investimi	2 miliardë euro
Specifikimet Teknike	– Sip. 81 ha – 12.000 njësive të banimit – 80.000 pemë
Fillimi i Punimeve	2023
Mbarimi i Punimeve	– Faza e parë zgjat 5 vite – Faza e dytë pritet të nisë në 2028-ën



INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRËS

Projekti	Hekurudha Tiranë-Durrës
Investimi	92.1 milionë euro
Specifikimet Teknike	– Gjatësi 35 km – Tiranë-Durrës për 22 minuta – Shpejtësia deri në 120 km/orë
Fillimi i Punimeve	2021
Mbarimi i Punimeve	2024



Projekti	Lungomare e Durrësit
Fondi	3 milion dollarë
Specifikimet Teknike	– Gjatësisë 3 km – Gjerësi nga 6 deri 10 metra
Fillimi i Punimeve	Faza e Parë - Tetor 2022 Faza e Dytë – 2024 e në vazhdim
Mbarimi i Punimeve	Faza e Parë - Qershor 2023



INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRËS

Projekti	Parku "Vala"
Investimi	186 milionë lekë
Specifikimet Teknike	– Sip. 8 000 m² – Fushë tenisi, volejboli, minikalçeto, palestër të hapur dhe fushë basketbolli.
Fillimi i Punimeve	2022
Mbarimi i Punimeve	2024



Projekti	Parkimi Publik
Investimi	477 milionë Lekë
Specifikimet Teknike	– 396 vende parkimi – 7 nivele godine
Fillimi i Punimeve	Prill 2023
Mbarimi i Punimeve	Prill 2024



INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN Durrës

Projekti	Stadiumi i Ri “Niko Dovana”
Investimi	– Projekti i studios 51N4E - 36 milionë lekë
Specifikimet Teknike	– Kapacitet 12 mijë vendesh – Parashikon fusha stërvitje basketbolli, futbollit, dy pishina për sportin e notit – Aktiv në 7 ditë të javës



Projekti	Aksi i ri rrugor Thumanë – Kashar
Investimi	Me koncesion, pjesë e Korridorit Blu
Specifikimet Teknike	– Gjatësi 21.05 km – 11 ura, 12 nënkalime – Shpejtësia max. 140 km/h
Fillimi i Punimeve	2020
Mbarimi i Punimeve	2024



INVESTIMET STRATEGJIKE NË QARKUN DURRËS

Projekti	Eko Parku
Investimi	15 milionë euro
Specifikimet Teknike	– Sip. 15.5 ha – Fusha dhe ambiente për aktivitete të ndryshme sportive dhe argëtuese.
Fillimi i Punimeve	2020
Mbarimi i Punimeve	Faza përfundimtare e kalimit në bashkinë Durrës



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE DHE VENDORE

RINDËRTIMI

- Prefekti i Qarkut gjatë vitit 2023 ka ndjekur dhe monitoruar procesin e rindërtimit nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Puna e tij ka konsistuar në shqyrtimin e bazueshmërisë ligjore, konfirmimin ose jo të akteve normative të Këshillave Bashkiak si dhe ka monitoruar punën që po kryhet kryesisht në drejtim të zonave për rindërtim, rforcimit të pallateve të dëmtuara, rikonstruksionit të banesave individuale si dhe në dhënien e granteve dhe dëmshpërblimeve për të gjithë banorët përfitues për kategoritë DS1, DS2 dhe DS3.
- Gjatë gjithë periudhës Janar - Dhjetor 2023 në të tre bashkitë e qarkut ka vazhduar ndërtimi i zonave të reja të banuara ku më poshtë po paraqesim një tabelë me këto të dhëna:



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN VENDORE

RINDËRTIMI

Bashkia	Zonat e rindërtimit	Banesa individuale	Pallate	Apartamente	Përfunduar	Në proces
Durrës	Zona 4 Spitallë		85	996		✓
	Zona 1 Nj. Ad. Manëz	140	9	226	✓	
	Nj. Ad. Ishëm	339			125	214
	Nj. Ad. Të tjera	1098			431	667
Shijak	Zona 1		31	665	✓	
Krujë	Zona 1 Nj. Ad. Bupq	78	7	45	✓	
	Zona 1 Nj. Ad. Thumanë	155	14	278	✓	
	Zona 1 Nj. Ad Fushë-Krujë	167	15	100	✓	
	Zona 1 Bashkia Krujë		22	336	3	19

Qarku Durrës	Rikonstruktion të pallateve (DS3-DS4)
Total	139 (në proces)

DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA

- Realizimi i këtyre detyrave është kryer nëpërmjet koordinimit të punës dhe bashkëpunimit midis Institucioneve Qëndrore dhe Vendore në nivel Qarku.
- Pavarësisht punës së mirë, problem mbetet pjesmarrja dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve.

TURIZMI

Për mbarëvajtjen e sezonit Turistik Veror 2023 u ngritën dy grupe pune sipas Urdhërit të Prefektit të Qarkut Durrës Nr. 25, datë 28.03.2023.

Grupi i parë i Task-Forcës si më poshtë:

1. Përfaqësues i Institucionit të Prefektit;
2. Përfaqësues të Policisë Vendore Durrës (Stacionit të Policisë Plazh);
3. Përfaqësues të Policisë Vendore Durrës (Posta e Policisë Manëz);
4. Përfaqësues të Policisë Vendore Durrës (Posta Vendore e Policisë Gjiri i Lalëzit);
5. Përfaqësues i Drejtorisë së Urbanistikës, Bashkia Durrës;
6. Përfaqësues i Policisë Bashkiake, Bashkia Durrës;
7. Përfaqësues i Policia Kufitare dhe Migracionit;
8. Përfaqësues i Agjensisë Kombëtare të Bregdetit;



TURIZMI

Grupi i dytë i Task-Forcës ka kryer kontroll përgjatë vijës bregdetare, e përbërë nga Institucioni Prefektit të Qarkut Durrës, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (Higjena), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Agjensisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër dhe Shërbimi i Mbrojtjes ndaj Zjarrit. U kontrolluan të gjitha sipërmarrjet e shërbimit në vijën e pare të bregdetit (restorante, lokale bar kafe).



TURIZMI

KAPACITETI HOTELERI SHTRETËR:

168 hotele

4859 dhoma

11,528 shtreter

HYRJE-DALJE NË PORTIN E DURRËSIT:

Për sezonin turistik veror 2022 janë regjistruar të dhënat si më poshtë:

Një ndër aspektet më të rëndësishme për t'u krahasuar midis sezonit turistik veror 2022 dhe sezonit turistik veror 2023 është numri i pushuesve të huaj të cilët arritën një rekord të ri për turizmin në Qarkun e Durrësit, përtej çdo pritshmërie. Në vitin 2022 pushuesit e huaj ishin 369813, ndërsa në vitin 2023 ato arritën në 440388.



TURIZMI

Nga data: 01.01.2022 deri në datën: 31.12.2022

Numri i Shtetasve dhe Automjeteve që kanë Hyrë/Dalë në PKK Port Durrës

Nr	Hyrje-Dalje	Shtetas	Automjete
1	Hyrje Shtetas Shqiptarë	250747	96936
2	Dalje Shtetas Shqiptarë	226507	79650
3	Hyrje Shtetas të Huaj	178320	60431
4	Dalje Shtetas të Huaj	191493	62567
TOTALI		847067	299584

Nga data: 01.01.2023 deri në datën: 31.12.2023

Numri i Shtetasve dhe Automjeteve që kanë Hyrë/Dalë në PKK Port Durrës

Nr	Hyrje-Dalje	Shtetas	Automjete
1	Hyrje Shtetas Shqiptarë	256330	103302
2	Dalje Shtetas Shqiptarë	205858	79195
3	Hyrje Shtetas të Huaj	218095	75047
4	Dalje Shtetas të Huaj	222293	72899
TOTALI		902576	330443

TURIZMI

Rezultatet e arritura të krahasueshme midis sezonit turistik veror 2022 dhe sezonit turistik veror 2023:

1. Në sezonin turistik veror 2022 ndarja e midis plazheve publike dhe private ishte **20% publik** dhe **80% privat**. Në sezonin turistik veror 2023 ishte **30% plazh publik** dhe **70% plazh privat**, duke shënuar një përparim në rritjen e raportit të ndarjes së stacioneve të plazhit midis atij publik dhe atij privat.
2. Ruajtja e hapësirave kushtuar plazheve publike në të gjithë vijën bregdetare të Durrësit gjatë sezonit turistik veror 2023 ishte shumë më mirë e organizuar dhe e monitoruar nga Policia Bashkiake Durrës, duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj pushuesve;
3. Gjatë sezonit turistik veror 2023 **vendbazimet** ishin shumë më mirë të monitoruar nga Policia Bashkiake Durrës, Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Policia e Shtetit në krahasim me sezonin turistik veror 2022. Kjo, pasi në 2023 nuk u lejua asnjë sipërmarrës të shfrytëzoi vendbazimet dhe mjetet motorike për argëtim nëse nuk ishte i pajisur me **Certifikatën e Operatorit Turistik** të lëshuar pas përmbushjes së të gjitha kriterëve të kërkuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

TURIZMI

4. Në krahasim me **sezonin turistik 2022** respektimi i vendosjes së **kullave të vrojtimit** me largësi mes tyre prej **80 m**, në **sezonin turistik veror 2023** ishte dukshëm shumë mirë i organizuar, të mirë vendosuara dhe të pajisura me të gjitha të dhënat dhe pajisjet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpjeguese ndaj pushueve në nevojë, duke përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara në ligjin për turizmin. Risi për sezonin turistik veror 2023 në kuadër të kullave të vrojtimit ishin edhe zëvendësimi i tyre me praninë e një **çadre të parë, e cila kishte funksionin e një kulle vrojtimi**;

5. Respektimi dhe përmbushja me përgjegjësi e rolit të **rojes bregdetare** pavarësisht të gjitha pajisjeve të nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë, gjatë sezonit turistik veror 2023 në mënyrë sporadike nuk ka qenë në nivelin e kërkuar. Në këtë drejtim sezoni turistik veror 2022 rezultoi më i suksesshëm për sa i përket cilësisë së shërbimit të Rojeve Bregdetare;

TURIZMI

6. Pajisja e të gjithë subjekteve të shërbimit bar, restorant, hoteleri dhe beach bar me **certifikatën higjeno-sanitare** për sa i përket analizës së ujit në sezonin turistik veror 2023 pati një rritje të prekshme cilësore në krahasim me sezonin turistik veror 2022. Pajisja e të gjithë subjekteve të shërbimit në vijën e parë të bregdetit me këtë certifikatë është tregues i cilësisë dhe sigurisë së shërbimit ndaj pushuesve;
7. Ndër kriteret që vijon të mbetet konstant nga sezoni turistik veror 2022 në atë të vitit 2023 është respektimi me përpikmëri i **hapësirave në vendosjen e çadrave mes tyre prej 3 m dhe nga bregu i detit prej 7 m.**

TURIZMI

Problematika të hasura:

1. Mungesa në mënyrë sporadike e vendosjes së kutiave të zeza për mijtë;
2. Mungesa në mënyrë sporadike e pajisjes së personelit të shërbimit me librezën shëndetësore;
3. Qarkullimi masiv i shitësve ambulant në vijën bregdetare;
4. Mungesa e pajisjes së sipërmarrësve që shfrytëzonin vendbazimet me Certifikatën e Operatorit Turistik nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
5. Mungesa në mënyrë sporadike në kullën e vrojtimit të vrojtuesve të plazhit.

TURIZMI

Objektivat për sezonin turistik veror 2024:

1. Koordinimi i punës me institucionet përkatëse për mbrojtjen me sukses të sezonit turistik veror 2024;
2. Kontrolli dhe ndërgjegjësimi i sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vijën e parë të detit për një shërbim më cilësor ndaj klientit, duke respektuar maksimalisht të gjitha kriteret dhe rregullat e përshkruar në ligjin për turizmin;
3. Pajisja me Certifikatën e Operatorit Turistik të të gjithë sipërmarrësve që kërkojnë të shfrytëzojnë vendbazimet me mjetet e tyre motorike për argëtim të përcaktuara me vendim të Këshillit Bashkiak Durrës;
4. Ndërgjegjësimi dhe respektimi me shumë rigorozitet i pranisë dhe funksionin e Rojes Bregdetare;
5. Mirë kontrollimi dhe ndalimi i shitësve ambulantë përgjatë vijës bregdetare;
6. Mirë organizimi i akseve rrugore pranë zonave turistike detare për shmangien e mbingarkimit të tyre nga flukset e mëdha të pushuesve.

TASK-FORCA PËR SIGURINË NË SHKOLLA

Sipas porosisë së Ministrit të Brendshëm në shtator 2023 u ngrit **Task-Forca për Sigurinë në Shkolla**, e cila ka qenë një risi për sistemin arsimor parauniversitar shqiptar për vitin shkollor 2023-2024. Në këtë drejtim Institucioni i Prefektit ka ndjekur dhe monitoruar me përpikmëri udhëzimet e Ministrit të Brendshëm, duke raportuar çdo të premte në Ministrinë e Brendshme.

Kjo Task-Forcë përbëhet nga institucionet si më poshtë:

1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës;
2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës;
3. Koordinator i Oficerëve të Sigurisë Durrës;
4. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shijak;
5. Koordinator i Oficerëve të Sigurisë Shijak;
6. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Krujë;



TASK-FORCA PËR SIGURINË NË SHKOLLA

7. Koordinator i Oficerëve të Sigurisë Krujë;
8. Drejtoria Vendore e Policisë Durrës;
9. Bashkia Durrës;
10. Policia Bashkiake Durrës;
11. Bashkia Shijak;
12. Policia Bashkiake Shijak;
13. Bashkia Krujë;
14. Policia Bashkiake Krujë;
15. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës;
16. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Durrës;
17. Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpitimi Durrës.



TASK-FORCA PËR SIGURINË NË SHKOLLA

Arritjet:

Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore zbatimi i Paketës së sigurisë në Shkolla ka patur disa arritje të rëndësishme si:

1. Nadlimi dhe marrja e masave administrative nga Policia Bashkiake ndaj shitësve ambulantë brenda perimetrit të sigurisë së shkollave;
2. Inspektimi dhe marrja e masave paralajmërim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për të gjithë subjektet të cilat tregtojnë jo konformë kriterëve të kërkuara produkte ushqimore si: fast food, supermarket, markete, piceri, byrektore, etj;
3. Parandalimi i përplasjeve fizike mes nxënësve dhe ruajtja e etikës nga Oficeri i Sigurisë brenda mjediseve dhe perimetrit të sigurisë në shkolla;
4. Konstatimi dhe ndalimi i lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit brenda mjediseve dhe perimetrit të sigurisë në shkolla;
5. Inspektimi dhe ndalimi i pijeve alkoolike dhe energjike nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor të subjektet tregtuese afër perimetrit të sigurisë në shkolla;


TASK-FORCA PËR SIGURINË NË SHKOLLA

Problematika të hasura:

1. Mungesa kolaudimit të fikseve të zjarrit dhe mos funksionimi i rrjetit hidrant në disa institucione arsimore parauniversitare;
2. Mungesa e Akt Miratimit Higjieno Sanitar dhe analizës së ujit në pothuajse 90% të institucioneve arsimore publike;
3. Qëndrimi i të rinjve jashtëshkollorë rreth shkollave, kryesisht gjimnazeve;
4. Lëvizja e mjeteve me shpejtësi pranë shkollave;

TASK-FORCA VENDORE ANTI KANABIS

Kriminaliteti




	viti 2022	Viti 2023
■ vepra penale	57	30
■ zbuluar	30	17
■ autorë	53	30
■ arrest/ndaluar	1	12
■ gjendje të lirë	18	10
■ shpallur në kërkim	16	8

Gjatë **periudhës Janar – Dhjetor 2023**, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë :

- Janë evidentuar **30** vepra penale, zbuluar **17**, me **30** autorë nga të cilët **12** janë arrestuar/ndaluar, **10** ndiqen në gjendje të lirë dhe **8** janë shpallur në kërkim.

TASK-FORCA VENDORE ANTI KANABIS



Zbulueshmëria


- Janë konstatuar **107** ambjente kultivimi, nga të cilat **103** janë ambjente të hapura dhe **4** janë ambjente të mbyllura, me **11.178** bimë narkotike të asgjësuar/sekuestruar, nga të cilat **1104** janë gjetur në tre shtëpi bari dhe **1** miniserë.

KOMITETI RAJONAL ANTI TRAFIK

KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIK (KRAT)

- Në fillim të vitit u hartua Plani i Veprimit për vitin 2023 i cili u miratua në takimin e parë.
- Në këtë plan u përfshinë: organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjëse në nivel lokal për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e Viktimave të Trafikimit/Viktimave të Mundëshme të Trafikimit gjatë gjithë vitit, veçanërisht gjatë muajit tetor, në përmjet formave të komunikimit si: Spote ndërgjegjëse mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio & televizione lokale.
- U realizuan fushata ndërgjegjësi në terren dhe online nëpërmjet faqes së mediave sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit online.
- **KRAT Durrës** vetëm gjatë muajit tetor antitrafik, ka zhvilluar rreth **25** aktivitete të ndryshme informuese dhe sensibilizuese, ku të gjitha strukturat e Tryezës Teknike u angazhuan dhe shpërndanë fletëpalosje, video informuese, mesazhe sensibilizuese për fenomenin e trafikimit.

KOMITETI RAJONAL ANTI TRAFIK



Për periudhën Janar – Dhjetor janë menaxhuar **pesë (5)** raste në total viktima të mundëshme trafikimi me status **VMT** dhe viktima trafikimi është **(një) 1 VT**, një e rritur e shfrytëzuar për prostitucion e cila është dërguar në qendrën pritëse në Tiranë.

KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

► Gjatë vitit 2023 kemi patur në vëmendje të punës tonë në bashkëpunim edhe me Administratën e Zonave të Mbrojtura Mjedisore, zonat e mbrojtura mjedisore. Në qarkun Durrës janë 4 zona të mbrojtura:

1. **Parku Kombëtar (PK) “Qafë-Shtamë”**, shpallur me VKM nr. 102, datë 15.01.1996, sipërfaqe 2000 ha. Me shtesat e VKM nr. 60 datë 26.01.2022 bëhet Park Natyror me një sipërfaqe shtesë rreth 4864 ha . Sipërfaqe totale e saj shkon në 6864.36 ha.
 2. **Pjesë nga Parku Kombëtar (PK) “ Mali i Dajtit” Bovilla** shpallur me VKM nr. 402 datë 21.06.2006 me sipërfaqe 2440 ha.
 3. **Peisazhin Toksor Ujor i Mbrojtur (PTUM) “Rrushkull”** shpallur me Urdhër Nr.2 MB datë 26.12.1995 me sipërfaqe 564.73 ha.
 4. **Pejsazhi i Mbrojtur (PM) “Krast-Vrion”** shpallur me VKM Nr.468 datë 26.07.2018 me sipërfaqe 1469.23 ha.
 5. **15 Monumente Natyre (MN)** me VKM nr.303 datë 10.05.20219 me sipërfaqe 833.18 ha.
- **Totali i sipërfaqes i Zonave të Mbrojtura në Qarkun Durrës shkon në 11 365.76 ha.**

► Pritet të shtohet me VKM-në përkatëse edhe **Peisazhi Toksor Ujor i Mbrojtur (PTUM) “Bisht Kamëz”** me një sipërfaqe 491ha, Me KKT Nr.10 2020.



DURRËS

KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

► Është realizuar monitorimi i vazhdueshëm për mbrojtjen dhe menaxhimin e ZMM-re, në mënyrë të veçantë në drejtim të mbrojtjes së tyre nga:

- ndërtimet pa leje;
- shfrytëzimi i guroreve nga subjektet;
- zjarret,
- shpyllëzimi

Nisur nga këto aspekte në rolin edhe të drejtuesit të Komitetit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, Prefekti i Qarkut ka zhvilluar **2 takime** me strukturat përgjegjëse, si dhe ka patur korenspondenca të ndryshme në lidhje me koordinimin e punës dhe veprimin në zbatim të ligjit në këto zona.

Si rezultat i koordinimit, bashkërendimit të punës së Komitetit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore gjatë vitit 2023 në Zonat e Mbrojtura Mjedisore **janë ndjekur dhe realizuar këto detyra:**

- Është hartuar që në fillim të vitit plani operacional i masave ndaj zjarrit dhe skuadrat e zjarreve në mbrojtjen e ZM të Qarkut Durrës. **Për vitin 2023 ka vetëm një rast zjarri me sip. 0.08 ha PM Krastë-Verjon (djegur pishë e egër).**
- Është realizuar mbjellja e fidanëve në disa shkolla dhe zona të djegura pjesë të Zonave të Mbrojtura. Gjithsej janë mbjellur **1500 fidanë pishë** dhe **100 fidanë Manjolë**. Rreth **13000 fidanë pishë mesdhetare dhe akacie janë mbjellur (zëvendësime nga subjekti privat) në objektin Makaresh- Zidoll nga subjekti Hastoci shpk në PM “Krast – Vrion”. (Në vitin 2022 në drejtim të rivitalizimit të ZMM janë mbjellur rreth 2500 fidanë, kryesisht në Parkun Natyror Qafështamë, Parkun Kombëtar Dajt dhe në shkolla të ndryshme të qarkut.)**
Vihet re një rritje e sasisë së fidanëve të mbjellura përgjatë viti 2023



KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

- Në Zonat e Mbrojtura Natyrore janë realizuar rreth **26 aksione pastrimi**. Në vitin 2022 numri i aksioneve të realizuara ka qenë 25 aksione.
- Nga strukturat e Ad.Z.M pjesë e sekretariatit Teknik dhe strukturë kryesore e Komitetit janë realizuar rreth **33 orë mjedisore në shkollë** dhe **rreth 15 takime** me banorët e zonave të mbrojtura të Qarkut Durrës **për njohjen, vlerat dhe mbrojtjen e këtyre zonave**.
- **Janë hartuar 10 proces-verbale** nga të cilat:
 - 2 raste prerje drurësh në PN Qafështamë
 - 1 rast prerje drurësh në PK Dajt
 - 2 furra gëlqereje në PM Krast Vrion (riaktivizim)
 - 1 rast gjermimi në një sip 50 m² në MN Gryka –Vajës
 - 1 rast gjermimi në PM Krast – Vrion
 - 1 rast zjarri në PM Krast – Vrion, ku janë djegur 0.08 ha pishë
 - 1 rast përvetësim materiali drusor
- (Në vitin 2022 AdZM Durrës ka hartuar 13 proces-verbale konstatimi konkretisht: 4 raste zjarresh 2 në PM Krast-Verion dhe 2 në Qafështamë; 3 raste prerje drurësh; 2 raste ndotje ambienti; 3 raste furra gëlqereje dhe 1 rast gjermimi.)
- Deri në fund të nëntorit të vitit 2023 ZM të AdZM Durrës janë vizituar nga **252 300 vizitorë**, **224 400 janë turistë vendas** dhe **27 900 janë turistë të huaj**. (Numri i vizitorëve në vitin 2022, 284 700 gjithsej dhe 254 950 janë vendas dhe 29 750 janë vizitorë të huaj.)



KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

- Gjatë vitit 2023 **nuk ka ndërtime pa leje** në zonat e mbrojtura mjedisore.
- Po kështu **nuk ka patur raste të gjuetisë së paligjshme.**
- Pejsazhi i Mbrojtur “Krastë-Verjon” akoma nuk është dorëzuar nga Bashkia Krujë. (Me VKM Nr.468, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peisazh i Mbrojtur Natyror” **duhet të jetë nën administrimin e Ad.ZM Durrës Krujë.**)

Më poshtë po paraqesim disa problematika të evidentuara gjatë vitit 2023 në ZMM në qarkun Durrës dhe konkretisht:

➤ **NË PARKUN NATYROR “QAFËSHTAMË”**

- Mosmiratimi ende i Planit të Menaxhimit të Parkun Natyror “Qafë - Shtamë” nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (hartuar që në 2017). Pa u miratuar plani i menaxhimit për parkun nuk mund të ndërhyet dhe përmirësohet që të rritet shërbimi dhe numri i vizitorëve.
- Plotësimi dhe vënia në eficiencë e Infopoint në PN “Qafë - Shtamë” nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- Infrastruktura rrugore. Gjendja e rrugës së PN Qafështamë ka nevojë për përmirësime, për investim pasi ka problematikë erozini (rrëshkriteje dheu)
- Hapësirat e djegura të krijuara nga zjarri kanë nevojë për shëndetësime.
- Lind nevoja e më shumë kontrolleve ndaj kultivimit të bimëve narkotike.
- Procesionaria e pishës është dëmtuesi kryesor i pyjeve në PN Qafështamë e cila ka infektuar rreth 233 ha nga 700 ha totali.

KOMITETI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE

- **Erozioni mbetet një nga problemet më kryesore** të cilin e kemi prezent në **Bovillë, Parkun Kombëtarë Dajt** (fshatin Bruz - Mal dhe Bruz - Zall). Për këtë zonë nga strukturat e Ad.ZM është bërë një projekt pyllëzimi por ende nuk ka planifikim fondi.
- Erozioni mbetet një nga problemet edhe **në Peisazhin Toksor Ujor i Mbrojtur Rrushkull**. Deti ka avancuar në drejtim të tokës 70 - 80 m duke gllabëruar vitet e fundit sipërfaqe ranore dhe pyjore. Janë hequr rreth 75 ha nga fondi pyjor si zonë e mbrojtur për shkak të erozionit

► **Objektivat për vitin 2024 në drejtim të Zonave të Mbrojtura Mjedisore**

1. Ndjekja në mënyrë të vazhdueshme; të zbatimit të planit të pastrimit në ZMM, të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parqeve dhe pasurive natyrore.
2. Shtimi i vëmendjes në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse për prani të guroreve aktive, furrave të gelqeres, ndërtimeve pa leje, si dhe nxitja e zhvendosjes së tyre nga ajo zonë për ta rehabilituar atë.
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit në dhënien e informacionit në kohë dhe ndërhyrjen sipas rastit në raste zjarri.
4. Krijimin e kushteve për rritjen e sasisë së mbjelljeve të pemëve të reja, hapjen e shtigjeve të tjera turistike, rehabilitimin e infrastrukturës si dhe të mbrojtjes së faunës dhe florës.

ARSIMI

Gjatë gjithë vitit shkollor 2022-2023 janë monitoruar çështje të ndryshme si:

1. Rekrutimi i mësuesve të rinj në portalin qeveritar Mësues për Shqipërinë për vitin shkollor 2022-2023, ka vijuar sipas DRAP Durrës, ashtu si në vitin shkollor 2021-2022 të jetë në lartësinë e duhur për sa i përket mirë organizimit të procesit përzgjedhës të mësuesve sipas meritokracisë;
2. Cilësia dhe arritjet e mësuesve të rinj për marrjen e liçensës pas praktikës 1-vjeçare në institucionet e arsimit parauniversitar në Qarkun Durrës për vitin shkollor 2022-2023, në krahasim me vitin shkollor 2021-2022 ka qenë me notën mesatare 7 dhe me një kalueshmëri prej 55%;
3. Procesi i rindërtimit të shkollave si pasoj e tërmetit të 26 nëntorit 2019 vijon pa u ndalur në disa shkolla të mesme dhe 9-vjeçare, për përmbushjen e të gjitha objektivave të vendosur nga Bashkia Durrës, që në vitin e ardhshëm shkollor 2024-2025 të jenë të gjitha të përfunduara në shërbim të nxënësve me të gjitha standartet e institucioneve arsimore bashkëkohore;

ARSIMI

4. Sistemi i ngrohjes në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar të porsa ndërtuara dhe përmirësimi i këtij sistemi në shkollat e tjera ekzistuese në Qarkun Durrës, gjatë vitit shkollor 2022-2023 ka patur një përmirësim të prekshëm në krahasim me vitin shkollor 2021-2022, duke bërë që mjediset e këtyre shkollave të jenë më të ngrohta dhe më konformë kushteve për zhvillimin e procesit mësimor;
5. Shtimi i oficerëve të sigurisë, psikologëve, mësuesve ndihmës dhe punonjësve social në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në krahasim me vitin shkollor 2021-2022, në vitin shkollor 2022-2023 ka qenë në rritje dhe më cilësor, duke rritur njëherazi mësimdhënien dhe mësimnxënien, sigurinë, mbarvajtjen dhe cilësinë në të gjitha këto institucione me në qendër nxënësin.

ARSIMI

6. Të rëndësishme për vitin 2023 kanë qenë edhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore dhe ai i provimeve të Lirimit. Ashtu si në vitin shkollor 2021-2022 edhe në vitin shkollor 2022-2023 procesi i zhvillimit të provimeve të lirimit dhe të maturës shtetërore kanë qenë të suksesshme, si në drejtim të mirëorganizimit, ashtu edhe në drejtim të cilësisë dhe shmangies së çdo lloj problematike të mundshme përgjatë procesit të provimeve. Provimet e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2022-2023 u zhvilluan **në datat 01, 07, 13 dhe 19 qershor 2023**. Ndërsa provimet e Lirimit për klasat e nënta u zhvilluan **në datat 20, 23 dhe 26 qershor 2023**. Prosesi i provimeve u zhvillua normalisht nën monitorimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Zyrave Vendore Arsimore (ZVA) përkatëse.

ARSIMI

PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2022-2023:

DREJTORIA	NR. I QENDRAVE	NXËNËS TË REGJISTRUAR	NXËNËS PJEËMARRËS	NXËNËS TË MUNGUAR	PROBLEMATIKA
Zyra Vendore Arsimore Durrës	12	2652	2507	90	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
Zyra Vendore Arsimore Shijak	1	132	129	3	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
Zyra Vendore Arsimore Krujë	3	580	567	13	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
GJITHËSEJ	16	3364	3203	106	

ARSIMI

PROVIMET E LIRIMIT 2022-2023:

DREJTORIA	NR. I QENDRAVE	NXËNËS TË REGJISTRUAR	NXËNËS PJESEMARRËS	NXËNËS TË MUNGUAR	PROBLEMATIKA
Zyra Vendore Arsimore Durrës	20	2094	2069	25	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
Zyra Vendore Arsimore Shijak	5	249	249	0	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
Zyra Vendore Arsimore Krujë	7	728	700	28	Asnjë problem gjatë zhvillimit të provimit.
GJITHËSEJ	16	3071	3018	53	

ARSIMI

Problematika të ndjekura:

- Ankesa nga mësues të ndryshëm për vlerësimin e pikëzimit të dosjeve dhe renditjes përfundimtare për përzgjedhjen e vendit vakant në institucionin arsimor përkatës;
- Ankesa nga komuniteti i prindërve për mos funksionimin e sistemit të ngrohjes në disa institucione arsimore parauniversitare;
- Mungesa kolaudimit të fikseve të zjarrit dhe mos funksionimi i rrjetit hidrant në disa institucione arsimore parauniversitare;

Objektivat për vitin shkollor 2023-2024:

1. Ndjekja dhe monitorimi i Paketës për Sigurinë në Shkolla;
2. Ndjekja dhe monitorimi i fillimit të vitit të ri shkollor;
3. Ndjekja dhe monitorimi i procesit të provimeve të Maturës Shtetërore dhe provimeve të Lirimit;
4. Ndjekja dhe monitorimi i procesit të rindërtimit të institucioneve arsimore të pambaruara.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Vëmendja kryesore e Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave ka qenë:

1. *evidentimi dhe ndjekja e masave parandaluese për emergjencat civile në 3 (tre) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore të qarkut Durrës;*
2. *ndjekja e realizimit të tyre të projekteve;*
3. *si dhe angazhimi i struktuvave operacionale nëpërmjet koordinimit të Institucionit të Prefektit në rastet e situatave emergjente të krijuara, kryesisht gjatë periudhës së dimrit (si pasojë e rreshjeve të shiut me intensitet të lartë duke dale nga shtrati lumenjtë Ishëm dhe Erzen) dhe verës (si pasojë e temperaturave të larta dhe shtimit të qarkullimit të mjeteve dhe njerëzve duke shkaktuar zjarre).*

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

VËMENDJA E SHTUAR E QEVERISË, NËPËRMJET:

1. Thirrjes për aplikim për të gjitha Njësitë e Vetqeverisjes Vendore në programin “*Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive*”, program nga i cili;
 - Bashkia Durrës ka fituar 1 (një) projekt - Përforsim terreni nga rrëshqitja në zonën e NjA-ve nr.2, nr.4, Ishëm me vlerën prej **7,987,124 lekë (Kontrata është lidhur)**;
 - Bashkia Krujë ka përfituar 2 (dy) projekte - Punime për rehabilitimin e shkarkuesit, Rezervuari “Vrijon” dhe sistemim i përroit lagja nr. 3, Kovaçe me vlerën prej **16,785,902 lekë (Vijon puna në terren)**.
2. Transfertes për përdorim të fondit prej **78,065,811 lekë (llogaria 231 - 24,773,026 lekë dhe llogaria 604 – 53,292,785 lekë)**, nga buxheti i shtetit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, për 3 (tre) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore të qarkut Durrës.
3. Mirëmbajtja e Kanalave të Ujërave të Larta (K.U.L) të bëra nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës si;
 - Gjatësia e pastruar në nivel qarku është 23,500 ml;
 - Bashkëpunimi me bashkitë për pastrimin e kanaleve në administrim të bashkive (**për tu përmendur ndihma ndaj Bashkisë Durrës për ndërtimin e 1500 ml argjinaturë në Njësinë Administrative Sukth**)

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

KOMISIONI I MBROJTJES CIVILE

1. Mbledhja të planifikuara në planin vjetor (*për sezonin veror dhe sezonin dimëror*): 2;
2. Mbledhje jashtë rradhe (*situata e rëndë në datën 24 shtator me 16 vatra zjarri në nivel qarku dhe Pastrimi i kanaleve, argjinaturat, hidrovorët dhe rezervuarët*): 2;
3. Inspektime në M.Z.Sh-të: 3;
4. Inspektime në Argjinaturë, KUL, Hidrovorë, Rezervuarë: 8;
5. Takime në Njësitë Administrative me nivel të lartë risku: 5;
6. Pjesëmarrje në mbledhje të Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile: 1

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

SEZONI PRANVERE - VJESHTE ZJARREVE

Gjatë periudhës së nxehtë të vitit 2023, në fokus të vëmëndjes së të gjitha strukturave operacionale kanë qenë zjarret. Duke e krahasuar me vitin e kaluar vihet re se ka një përmirësim në: **"Sistemin e Raportimit" në dhënien e njoftimit në kohë për zjarr.**


Kjo gjë ka bërë që reagimi i strukturave operacionale të jetë në kohë, duke ndikuar në izolimin e shpejtë të vatrave të zjarrit.

Ky mirëmenaxhim i sezonit veror ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit mes gjithë strukturave : M.Z.SH-së, Policia e Shtetit, Repartit të M.Z.SH-së të Autoritetit Portual, strukturave përgjegjëse të bashkive.

Duke krahasuar numrin e ngjarjeve të shkaktuara nga zjarret, në vitin 2022, kemi një ulje e konsiderueshme në numrin e zjarreve në të 3 Bashkitë, kjo si rezultat i veprimeve reaguese në kohë nga të gjitha forcat operacionale.


SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

ZJARRET NË BANESA, AKTIVITETE TREGTARE, PYJE, KULLOTA,
HAMULLORE, SHKURRE, BARISHTE



SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

ANALIZA E ZJARREVE DREJTORIA VENDORE E POLICISE



Viti 2022 / 2023

VEPRA PENALE ZBULUAR ARRESTUAR NDALUAR GJËNDJE TË LIRË

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE


KANALE TE PASTRUARA, ARGJINATURA

Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave kanë kryer inspektimin në terren të punës në lidhje me pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe ujërave të larta, që janë nën administrimin e Bashkive dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit.

Menaxhimi i kanaleve në kohën e duhur, para fillimit të rreshjeve, bëri të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmytjeve.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

KANALE TË PASTRUARA, ARGJINATURA



BASHKIA DURRËS	
BASHKIA KRUJË	
BASHKIA SHIJAK	
D.U.K	
TOTALI	

VITI 2022

58119

19907

12940

21000

111966

VITI 2023

24943

27032

3841

23500

79316

Viti 2022 / 2023

BASHKIA DURRËS

BASHKIA KRUJË

BASHKIA SHIJAK

D.U.K

TOTALI

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Bashkia Durrës:

Nisur nga përvoja e deritanishme, i është kushtuar një vëmendje e madhe ndërhyrjes në argjinatura në lumin Erzen, e cila e përkthyer në njësinë ml është 1500 ml (*Sukth dhe fshatin Rrotull*);

Bashkia Krujë:

Në Thumanë, Luz, Tapizë, Bilaj, Murqinë, Mallkuç, Derven, etj.;

Bashkia Shijak:

Kanali i parë i njohur si “*Kanali i Gjermanit*”, në Hardhishtë dhe në kanalin vaditës Ndroq-Callike. **Për shkak të një defekti të rëndë të mjetit eskavator puna ka ecur me ritme të ngadalta.**

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës:

K.U.L Fllakë-Det me gjatësi prej 12,000 ml;

K.U.L Shënavlash-Plepa me gjatësi prej 7,900 ml;

Përroi Budell me gjatësi prej 3,600 ml.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

REZULTATET E ARRITURA

1. Përmirësim i skemës së lajmërimit në kohë;
2. Rritja e bashkëpunimit mes strukturave përgjegjëse (*E.C., M.Z.Sh, P.Sh, AKMC*);
3. Fushatë ndërgjegjësimi në terren, media sociale;
4. Ulja e numrit të zjarreve në të 3 bashkitë (*332 raste më pak sesa viti 2022*) duke ndikuar në uljen e dëmeve qoftë monetar, qoftë material;
5. Janë zbuluar 49 raste të zjarrvënies nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës (36 raste më shumë sesa në vitin 2022);
6. Puna për ndërtimin e 1500 ml argjinaturë (*provizore*) në lumin Erzen (*Njësia Administrative Sukth*);
7. Financimi i 3 (tre) projekteve (*1 Bashkia Durrës dhe 2 Bashkia Krujë*), fituese në programin “Fondi për parandalimin e fatkeqësive natyrore”;
8. Eksperimentimi i hapjes së një grupi me drejtuesit e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Durrës, si bashkia qëndër qarku dhe me shtrirje të madhe në teritor dhe me nivel të lartë risku (*format i njëjtë me atë të grupit kombëtar të emergjencave civile*) dha rezultate pozitive në drejtimin të njoftimit në kohë për rastet e zjarrit apo fatkeqësive të tjera;
9. Bashkëpunimi i ngushtë me OSSHEE ka mundësuar që energjia elektrike në hidrovë të mos shkëputet asnjë moment.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

PROBLEMATIKAT

1. Nevoja për rehabilitimin sidomos të Lumit Ishëm pasi këtu paraqitet situata më e domosdshme (*kemi kërkuar mbajtjen e një takimi të nivelit të lartë vendimmarrës dhe teknik*);
2. Mungesa në kapacitete të M.Z.SH-ve në mjete, pajisje, efektivë zjarrfikës (*sidomos në bashkinë Durrës*);
3. Mungesa e 2 nënstacioneve zjarrfikëse (*minimalisht*) të përhershme (*1 për Bashkinë Durrës dhe 1 për Bashkinë Krujë*). *Autoriteti Portual Durrës (Stacioni zjarrfikës) ka ndihmuar në 58 raste zjarri, M.Z.Sh-ja Kamëz ka ndihmuar në 19 raste zjarri*;
4. Kurora e digave të rezervuarëve: Rubjek 1, Rubjek 2, Gjepalaj, Shetel (*Bashkia Shijak*);
5. Mungesa e një udhëzimi/urdhri për Komisariatit e Policisë Krujë (*si pjesë e D.V.P.T nga 1 qershori 2023*) në lidhje me raportimin për rastet e emergjencave në territorin e Bashkisë Krujë (*kemi dërguar një shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë*);
6. Përdorimi i fondit të kushtëzuar në fushën e mbrojtjes civile alokuar bashkive nga buxheti i shtetit;
7. Mungesa e burimeve njerëzore apo financiare për hartimin e paketës me 3 (*tre*) dokumentat strategjike të emergjencave civile;
8. Mungesa në hidrovorë të punonjësve elektrikistë siç e parashikon ligji Nr. 8734, datë 02.01.2001 “*Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike*”, i ndryshuar;
9. Mungesa e Hidrantëve për furnizimin me ujë të mjeteve zjarrfikëse, sidomos në zonat me nivel të lartë risku për zjarret;
10. Mungesa e një VKM-je/Urdhëri/Udhëzimi për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku (*aktualisht tani funksionojmë me Udhëzimin e Ministrit nr. 16, datë 11.07.2003 “Për ngritjen e Komisionit të Planifikimit të Emergjencave Civile në Nivel Qarku”*).

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

OBJEKTIVAT

1. Nisja e hartimit të 2 (dy) dokumentave strategjike të emergjencave: Vlerësimin e riskut në nivel qarku dhe Planin për Emergjencat Civile në nivel qarku;
2. Përditësimi i Planit Kundër Ndotjes Detare të shkallës së II-të për vitin 2024;
3. Përmirësimi akoma më shumë i “*Sistemit të Raportimit*”, duke nisur fillimisht me hapjen e grupit me anëtarët e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut;
4. Organizimi në terren i takimeve në kuadër të sensibilizimit, përmirësimit të sistemit të njoftimit, bashkëpunimit mes strukturave përgjegjëse në rastet e zjarreve (*në zonat me risk të lartë, nisur nga përvoja e viteve të shkuara*);
5. Fitimi i 6 (*gjashtë*) projekteve (në nivel qarku) në programin “Fondi për parandalimin e fatqësive natyrore” dhe programin “Fondi për digat” (*të 3 bashkitë i kemi njoftuar sapo është shpallur projektbuxheti për vitin 2024 për nisjen e punës për hartimin e projekteve*);

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Vijimi i punës për Argjinaturën në lumin Erzen në pjesën e Njesisë Administrative Katund i Ri;

Pastrimi i kanalit ushqyes Rubjekë-Borç, së bashku me një pjesë të përroit të Tonës (*Bashkia Shijak*) në bashkëpunim me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit – Rajoni Durrës,

Rekomandimi i vazhdueshëm tek bashkitë për ta përdorur fondin e kushtëzuar për mbrojtjen civile sipas prioritizimit;

Pjesëmarrja gjatë punimeve të Mbledhjeve Vendore të Komisionit të Mbrojtjes Civile;

Organizimi në terren i takimeve në kuadër të sensibilizimit, përmirësimit të sistemit të njoftimit, bashkëpunimit mes strukturave përgjegjëse në rastet e zjarreve (*në zonat me risk të lartë, nisur nga përvoja e viteve të shkuara*).

FUNKSIONET E DELEGUARA

GJENDJA CIVILE


Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009” Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar 2340 certifikata me vlerë 50 lekshë për shërbim brenda vendit, ku përfshihen **akte lindjeje, akte martese, akte vdekjeje, certifikata të përbërjes familjare** për vitet **1930, 1945 dhe 1950**. Ka lëshuar edhe **540 akte martese format të përkthyer në pesë gjuhë për përdorim jasht vendit**.

Shërbimi i Arkivës së Gjendjes Civile pranë Institucionit të Prefektit të qarkut Durrës më datë 1 / 10 /2023 kaloi përfundimisht me shërbim online sipas shkresës nr. 10181 Prot. i datës 28 / 09 / 2023. Falë këtij sistemi zyra e Arkivës së Gjendjes Civile ofron shërbim qytetarëve online për përbërje familjare të viteve 1930, 1945 dhe 1950 si dhe certificate nga akti i lindjes, martesës dhe vdekjes.



FUNKSIONET E DELEGUARA

DOKUMENTA TË LEGALIZURA



LEGALIZIMI I DOKUMENTAVE


Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit” janë legalizuar **6639** dokumenta të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.



FUNKSIONET E DELEGUARA

SHQYRTIMI I KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE NË FUSHËN E QARKULLIMIT RRUGOR


Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor” janë shqyrtuar **15** praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.



VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

EVIDENCË PËR AKTET NORMATIVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE 2023

Janar – dhjetor 2023



VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Gjatë vitit 2023 janë marrë gjithsej **357 vendime** nga organet e vetëqeverisjes vendore (**1 vendim** më shumë se viti i kaluar), **171 vendime** janë të bazuara në ligj ku është bërë dhe konfirmimi i tyre dhe **186 vendime** janë me karakter individual. Bashkia e Durrësit për të dyja vitet ka numrin më të madh të vendimeve duke qene se është dhe bashkia më e madhe e qarkut Durrës.

VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në zbatim të nenit 17 të po këtij ligji, institucioni i Prefektit ka verifikuar ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtëpërdrejtë dhe sistematikisht në të tre Bashkitë e Qarkut dhe Këshillin e Qarkut Durrës, çdo tre muaj.

Gjatë këtyre verifikimeve në vend të ligjshmërisë, nuk janë konstatuar akte normative të padepozituara tek Prefekti sipas procedurës së parashikuar në nenin 16 të këtij ligji, si rrjedhojë nuk kemi patur raste të këkesave për pavlefshmëri akti në Gjykatë.

Gjatë këtyre kontrolleve dhe në vazhdimësi gjatë punës tonë u kemi lënë organeve të vetëqeverisjes vendore rekomandimet tona me shkrim në lidhje me vazhdimësinë e punës së Këshillave Bashkiakë.

Disa nga rekomandimet janë si vijon:

Nevoja e rishikimit të rregullores së funksionimit të këtyre këshillave në mënyrë që cdo pikë e kësaj rregulloreje të mund të gjejë zbatim konkret nga këshilli gjatë punës së tij , rekomandim ky i nxitur edhe nga problematikat e lindura gjatë vijueshmërisë së punës së këshillave bashkiakë.

VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Gjithashtu në vijim të korespondencës sonë zyrtare edhe të më hershme kemi rekomanduar paraqitjen për verifikim të ligjshmërisë së akteve pranë Prefektit të Qarkut të cilat duhet të plotësojnë *kriteret që ka një akt nënligjor me karakter normativ* në zbatim të nenit 8/a të Ligjit nr Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe nenit 16 të këtij ligji. Aktet me karakter individual të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo nga Bashkia hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to (neni 55/6 i ligjit 139/2015), datë e cila duhet të shënohet në dispozitivin e vendimit si dhe nuk është e nevojshme të depozitohen tek prefekti i qarkut për verifikim ligjshmërie. Kjo bën të mundur edhe mos zvarritjen e individëve të cilëve u drejtohet ky akt, të cilët nuk ka arsyetim ligjor të presin afatin dhjetë ditor të verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti.

Gjithashtu kemi rekomanduar duke e parë të domosdoshëm dhe një objektiv thelbësor të punës në vijim të prefektit, respektimin e kreut VI të ligjit për vetëqeverisjen vendore mbi *transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare në çdo lloj vendim marrje* ku pjesëmarrja e komunitetit është kërkesë ligjore.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

MBI AKTIVITETIN E SEKTORIT TË FINANCËS E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE **PREFEKTI QARKUT DURRËS PËR PERIUdhËN**

JANAR-DHJETOR 2023

Në zbatim të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “ Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërin e Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Rregulloren e Brendshme të institucionit miratuar me Urdhërin e Ministrit Brendshm nr.175, datë 09.07.2020 “*Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të institucionit të Prefektit të Qarkut*” si dhe prioritetet dhe objektivat e institucionit, secili specialist dhe i gjithë sektori kanë të përcaktuar qartë detyrat për cdo vend pune. Mbi këtë bazë operohet dhe kërkohet zbatimi i këtyre detyrave të shtruar në vijueshmerinë e punës së gjithë stafit të institucionit të Prefekturës së Qarkut Durrës.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

I. Sektori Financës që në fillim të vitit në bashkëpunim me sektorët përkatës të Prefektit të Qarkut Durrës, bëri detajimin e buxhetit të vitit 2023 si dhe dha ndihmën parësore për tre Bashkitë, me qëllim që detajimi dhe vënia në zbatim e këtij buxheti të bëheshin saktësisht dhe në kohë. Kjo është kryer si me detajimet buxhetore, paketat fiskale, mbylljet vjetore apo ndjekjen e problematikave që shfaqeshin vazhdimisht në këto njësi. Po në këtë këndvështrim u punua dhe u krye dhe mbyllja e rezultatit ekonomik të Prefekturës si dhe u hartua programi vjetor i punës për vitin 2023.

Brenda muajit Janar 2023, u detajua buxheti i ri për vitin 2023 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile. Gjithashtu u dërgua Rregjistri i Realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2022. Ndërkohë u hartua dhe u miratua Rregjistri i Parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2023 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

II. Në zbatim të Urdhërit nr.5 prot datë 06.01.2023 të Prefektit të Qarkut Durrës është përcaktuar struktura e administratës së Prefektit me 28 punonjës, (bashkë me 2 punonjës të gjendjes civile) sipas pozicioneve të punës dhe me emrat e punonjësve. Nga DAP janë hapur procedurat dhe është bërë emërimi në muajin mars 2023 për dy specialist në Sektorin e Juridik dhe në muajin nëntor për sekretarin e përgjithshëm. Gjatë gjithë kësaj periudhe kanë qenë në marrëdhënie pune mesatarisht 25 punonjës, për të cilët janë kryer në afat hartimi i listpagesave, përlllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë.

Mbeten dhe tre vende vakant; 1 Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjecave Civile dhe 2 specialist në Sektorin Monitorimit të Kopetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

III. Në zbatim të ligjit nr.84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, është ndjekur përdorimi dhe administrimi i fondeve të vëna në dispozicion për aparatin e Prefekturës dhe atë të Gjendjes Civile. Kemi raportuar çdo muaj, evidencat e realizimit të treguesve buxhetorë në Ministrinë e Brendshme dhe në Degën e Thesarit.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Po të shohim të dhënat e fondeve buxhetore sipas zërave të shpenzimeve për vitin 2023, kemi këtë paraqitje.

PREFEKTURA VITI 2023 SHPENZIME PLANIFIKUARA			
Nr	Emertimi	VLERE	%
	SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	39.791.200	100.00
1	PAGA, SHPËRBLIME DHE TË TJERA SHPENZIME PERSONELI	27.131.000	68.2
2	KONTRIBUTE PËR SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE	4.535.000	11.4
3	MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	5.896.000	14.8
4	TRANSFERTA PËR BUXHETE FAMILJARE E INDIVIDË	229.200	0.6
5	INVESTIME	2.000.000	5

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Në buxhetin e vitit 2023, në total ku përfshihet Prefektura dhe Gjendja Civile, gjithsej janë 39,791.2 mijë lekë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet për paga të personelit në masën 27,131 mijë lekë ose 68,2 % të totalit, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore 4,535 mijë lekë ose 11,4 % të totalit, shpenzimet për mallra e shërbime 5,896 mijë lekë ose 14,8% të totalit dhe investime 2.000 mijë lekë ose 5% të totalit.

Pra gjatë këtij viti buxhetor është realizuar në mënyrë të kënaqshme një nga prioritetet e institucionit që është rritja e mirëqenies për të gjithë, me objektiva kryesore sigurimi i zhvillimit të rritjes ekonomike për më shumë të ardhura dhe ndjekja e rritjes së pagës për administratën e institucionit të prefektit.

Detyrë kryesore e punës së sektorit financës dhe shërbimeve mbështetëse është menaxhimi sa më racional i këtyre fondeve.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Në mënyrë analitike realizimi i fondeve buxhetore është si më poshtë:

Nr	Emertimi	Planifikuar	Realizim total	Diferenca leke	Ne %
	SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	39.791.200	39.250.864	540.336	98.64
1	PAGA PERSONELI	27.131.000	26.855.414	275.586	99
2	KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	4.535.000	4.424.248	110.752	98
3	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	5.896.000	5.829.403	66.597	99
4	TRANSFERTA PER BUXHET FAMILJAR E INDIVIDET	229.200	215.770	13.430	94
5	INVESTIME	2.000.000	1.926.029	73.791	96

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Siç shikohet në tabelë realizimi i fondeve buxhetore është bërë në mënyrë maksimale duke zbatuar përdorimin dhe administrimin e tyre me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

Pra realizimi i fondeve buxhetore në total është në masën 98.7 %, ose nga 39.791 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 39.251 mijë lekë, më pak 540 mijë lekë.

Sipas zërave përkatës shohim që pagesat për personelin u realizuan 98.98 % ose 275 mije lekë më pak. Për kontribute per sigurime shoqerore e shendetesore u realizuan 98.% ose 111 mije lekë më pak. Për mallra e shërbime të tjera realizimi ishte në masën 98.87%. % ose nga 5.896 mijë lekë në 5,829 mijë lekë, më pak 67 mijë lekë. Për investime realizimi ishte në masën 96.3%. % ose nga 2.000 mijë lekë në 1,926 mijë lekë, pra më pak 74 mijë lekë. Transferta per buxhet familjar e individet realizuar 94 %, ne masën 215 770 lekë.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Në analizë për shpenzimet në mallra e shërbime për administratën e Prefekturës, të dhënat janë si më poshtë:

REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE TOTAL PREFEKTURA PER VITIN 2022					
Nr	Emertimi	Planifikuar	Realizim total	Diferenca leke	Ne %
I	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	5.896.000	5.829.403	66.597	98.87
1	Materiale zyre dhe te pergjithshme	448.000	423.420	24.580	95
2	Materiale dhe sherbime speciale	81.600	81.600	0	100
3	Sherbime nga te trete	3.010.000	3.003.792	6.208	99.8
4	Shpenzime transporti	1.098.000	1096.350	1.650	100
5	Shpenzime udhetimi	30.000	30.000	0	100
6	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	794.000	770.320	23.680	97
7	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	0	0	0	
8	Shpenzime te tjera operative	434.400	423.921	10.479	98

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme nuk kemi tejkalim të shpenzimeve operative as në total dhe as sipas zërave, pra janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve. Këto shpenzime janë realizuar në masën 98.87%. Konkretisht nga 5.896 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 5.829 mijë lekë, pra më pak 66.6 mijë lekë.

Duke i analizuar shpenzimet operative sipas strukturës ato paraqiten si më poshtë:

- Materiale zyre dhe të përgjithshme, (kancelari, materiale pastrim e dezinfektimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, furnizime e materiale të tjera zyre), janë realizuar 95% ;
- Shërbimet nga të tretët (telefona, energji, ujë, shërbim postar, ruajtje fizike e godinës, faqja zyrtare, shërbim interneti dhe shërbime të tjera), janë realizuar 99.8%, të cilët zënë peshën kryesore të këtyre shpenzimeve nëmasë (51.5%);
- Shërbimet e transportit (naftë, pjesë këmbimi), janë realizuar 100%;
- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme janë realizuar 97%;
- Shpenzime të tjera operative janë realizuar 98%;

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Le të shohim më poshtë ecurinë e realizimit të fondeve sipas zërave të shpenzimeve për institucionin tonë në katër vitet e fundit:

REALIZIMI I FONDEVE BUXHETORE PËR PREFEKTURËN					
Nr	Emërtimi	2020	2021	2022	2023
	SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	25.091.735	28.736.283	28.101.434	39.250.864
1	PAGA PERSONELI	17.928.282	20.113.472	19.202.147	26.855.414
2	KONTRIBUTE PËR SIGURIME SHOQËRORE DHE SHENDETËSORE	2.909.263	3.329.503	3.185.373	4.424.248
3	MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	4.195.190	5.150.168	5.200.614	5.829.403
4	TRANSFERTA PËR BUXHET FAMILJAR E INDIVIDET	59.000	143.140.200	513.300	215.770
5	INVESTIME	0	0	0	1.926.029

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

Duke krahasuar realizimin e buxhetit të vitit 2023 me atë të viteve 2020, 2021, 2022 kemi përkatesisht një rritje prej 156.4 %, 136.6% dhe 139.7%. Kjo rritje kryesisht ka ardhur nga rritja e pagave të personelit dhe konkretisht kemi një rritje prej 149.8 %, 133.5% dhe 139.9%, pra kemi patur një rritje të nivelit të pagave me rreth 40%. Duke realizuar kështu një nga prioritet tona që është rritja e mireqënies për të gjithë dhe objektivi i rritjes së pagës për administratën e institucionit të prefektit.

IV. Është bërë ndjekja e realizimit të të Ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor 2023 të cilat raportohen për çdo muaj në Ministri dhe janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës. Për këtë periudhë të ardhurat janë realizuar në total 462.300 lekë, nga të cilat 23.115 lekë të ardhura për Ministrin e Brendshme dhe 439.185 lekë të ardhura për Buxhetin e Shtetit.

V. Gjatë këtij viti së bashku me komisionet përkatëse (komisioni i testimit, prokurimit dhe ai i marrjes në dorëzim), janë realizuar 18 procedura prokurimi me vlerë të vogël, nga 16 të planifikuara. E shprehur në vlerë monetare nga 3.912.339 lekë pa tvsh i përcaktuar fondi limit është realizuar 3.523.519 lekë pa tvsh. Nga procedurat e parealizuara është vetëm ai për shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative pasi nuk u nevojiti që të kryhet. Gjithashtu është dërguar në APP Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik për çdo katër mujor si dhe ai vjetor.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

VI - Është bërë shpallja e vendeve të punonjësve me status nëpunësi në sistemin HRMIS sipas kriterëve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013 “Për statusin e nënpunësit civil” për -3 pozicione; nga keto 2 kategori ekzekutive+1 drejtues i ulët.

Është bërë hedhja e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e përvojës së punës duke ndjekur trajnime periodike pranë shkollës ASPA.

U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013”Për statusin e nënpunësit civil” tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.

- Jane nxjerrë urdhërat për 2 automjetet në dispozicion të administratës së Prefektit duke zbatuar Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.112,dt.18.04.2014 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shoferëve si dhe disa rregulla për përdorimin e tyre”, në zbatim të tij është bërë dhe plotësimi ditor i fletë-autorizimeve të punonjësve të administratës, si dhe plotësimi mujor i fletë-udhëtimeve të shoferëve të automjeteve.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

VII Nga ana e Arkiv-Protokollit janë ka kryer çdo ditë të gjitha veprimet për pranimin, regjistrimin, ciklimin dhe shpërndarjen e korespondencës në bazë të Ligjit nr.9154 të vitit 2003 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat” si dhe rregullave të përcaktuara në rregulloren e Prefektit. Është mbajtur protokoll në të gjitha mbledhjet, takimet apo rastet e emergjences të organizuara nga Prefekti. Është mbajtur protokoll për të gjitha mbledhjet e Këshillit të Basenit Ujor. Janë mbajtur gjithësej **5 mbledhje** dhe janë dhënë **37 vendime** të natyrave të ndryshme.

IX. Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Ku janë realizuar aktivitete dhe takime të ndryshme, të cilat janë publikuar si në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale.

DETYRAT DHE PRIORITETET PËR VITIT 2024

- ▶ Ndjekja e zbatimit të planit të rindërtimit pas tërmetit, vazhdimi i planit kombëtar të pastrimit për mbajtjen pastër të ambjentit.
- ▶ Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar në arsim, shëndetësi, punësim, bujqësi, uji i pijshëm, energji, siguria publike dhe shërbimi zjarrfikës.
- ▶ Rritja e përgjegjësisë dhe anagazhimi i strukturave përkatëse në planifikimin dhe marrjen e masave për parandalimin e situatave të mundëshme emergjente dhe krizave në qark gjatë vitit 2024.
- ▶ Lufta kundër korrupsionit, forcimit të integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave, si rritja e performancës në Administratën Publike në nivel qarku.
- ▶ Verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve, të njësive të qeverisjes vendore dhe zbatimi i ligjshmërisë në veprimtarinë e Institucionit të Prefektit.
- ▶ Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes së tyre.
- ▶ Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit urban dhe mbrojtjes së mjedisit.
- ▶ Kontrolli i territorit, siguria dhe ruajtja e rendit publik.
- ▶ Zbatimi i Buxhetit të Institucionit të Prefektit.



FALEMINDERIT!